

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 153, datë 26.3.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.360, DATË 10.7.1995 “PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT NGA DHE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare e Energjetike, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995 “Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.415, datë 7.8.1995; nr.121, datë 12.2.1996 dhe nr.711, datë 21.10.1996, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “Mbeturina dhe skrape të bakrit (me përjashtim të skorjeve prej bakri)”, si dhe fjalët “Artikuj të tjerë prej bakri të derdhur” të ndryshohen dhe të zëvendësohen me fjalët: “74.01 deri në 74.19 Bakri dhe artikujt prej bakri”.

2. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ndalohet grumbullimi dhe tregtimi i bakrit dhe i artikujve prej bakri sipas klasifikimit të mallrave nga 74.01 deri në 74.19”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino